



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Pml.nr.656/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përberë nga gjyqtarët: Valdete Daka, kryetare, Mejreme Memaj e Rasim Rasimi, anëtarë, me bashkëpunëtorin profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen penale ndaj të dënuarit Azem Luta, nga K., rruga “A. dhe D. R.”, nr..., për shkak të veprës penale kontrabandim i mallrave, parashikuar me nenin 311 par.3 lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur përkitazi me kërkesën e mbrojtësit të dënuarit për mbrojtje të ligjshmërisë, avokatit Fitim Shabani, paraqitur kundër aktgjyqimit të formës së prerë të Gjykatës Themelore në Ferizaj - Departamenti i Përgjithshëm, nr.2021:234668 datë 1 dhjetor 2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me 25 shkurt 2025, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa e mbrojtësit të dënuarit Azem Luta për mbrojtje të ligjshmërisë, e paraqitur kundër aktgjyqimit të formës së prerë të Gjykatës Themelore në Ferizaj - Departamenti i Përgjithshëm, nr.2021:234668 datë 1 dhjetor 2023.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Ferizaj - Departamenti i Përgjithshëm, nr.2021:234668 datë 1 dhjetor 2023, të pandehurit Feriz Salihu, Azem Luta e Ajet Lajçi janë shpall fajtor për veprën penale kontrabandimi i mallrave, parashikuar me nenin 311 par.3 lidhur me nenin 31 të KPRK, për të cilën janë gjykuar:

- i pandehuri Feriz Salihu me dënim me burgim në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muajve, i cili dënim me pëlqimin e tij i është zëvendësuar në dënim me gjobë në shumë prej pesëmijë(5000)€, të cilën është obliguar që ta paguaj në afat prej 30 ditëve pas plotfuqishmërisë së aktgjyqimit.

- i pandehuri Azem Luta me dënim me burgim në kohëzgjatje prej pesë (5) muajve, i cili dënim me pëlqimin e tij i është zëvendësuar në dënim me gjobë në shumë prej katërmijë (4000)€, të cilën është obliguar që ta paguaj në afat prej 30 ditëve pas plotfuqishmërisë së aktgjyqimit.

- i pandehuri Ajet Lajçi me dënim me burgim në kohëzgjatje prej pesë (5) muajve, i cili dënim me pëlqimin e tij i është zëvendësuar në dënim me gjobë në shumë prej katërmijë (4000)€, të cilën është obliguar që ta paguaj në afat prej 30 ditëve pas plotfuqishmërisë së aktgjyqimit.

Konform nenit 79 par.1 të KPRK në dënimin e shqiptuar të pandehurve ju është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim prej 13.02.2020 deri me 5.04.2020 dhe arrest shtëpiak prej 6 prill 2020 deri me 3.08.2020. Konform nenit 311 par.6 të KPRK janë konfiskuar në mënyrë të përhershme barnat siç janë të përcaktuar në aktvendimin për konfiskim të përkohshëm dhe është urdhëruar shkatërrimi dhe asgjësimi i tyre (6917 kuti me barna sipas vërtetimit për konfiskim). Konform nenit 311 par.7 të KPRK, janë konfiskuar në mënyrë të përhershme:

-vetura “A.”, me targa të regjistrimit ..., me ngjyrë të zezë pronë e të pandehurit Feriz Salihu;

- vetura “T.”, me targa të regjistrimit ..., me ngjyrë të zezë pronë e të pandehurit Azem Luta;

- vetura “P.”, me targa të regjistrimit ..., me ngjyrë të hirit pronë e të pandehurit Ajet Lajçi, dhe

-parat në shumë prej njëmijë e tetëqind (1.800)€ siç janë përcaktuar me numër serik në vërtetimin mbi konfiskimin – pronë e të pandehurit Ajet Lajçi, kurse është kthimi i veturës T. me targa të regjistrimit ..., ngjyrë e zezë pronë e të pandehurit Feriz Salihu dhe paratë në shumë prej njëzet e gjashtë (26.000)€ në pronësi të pandehurit Azem Lutes

Në procedurën ankimore sipas ankesës së Prokurorit dhe mbrojtësve të të dënuarve Azem Luta e Ajet Lajçi, Gjykata e Apelit duke vendosur përkitazi me ankesat, i ka refuzuar ato kurse aktgjykimin e lartcekur e ka vërtetuar.

Kundër këtyre aktgjykimeve kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka paraqitur mbrojtësi i të dënuarit Azem Luta, avokati Fitim Shabani, për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal, me propozim që kërkesa të aprovohet aktgjykimet të ndryshohen ashtu që i dënuari të lirohet nga akuza apo të anulohen dhe çështja t’i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

Prokurori i Shtetit me parashtresën me shkrim KMLP.nr.379/2024 datë 25 tetor 2024 ka propozuar që kërkesa e mbrojtësit të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoj shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par.1 dhe 436 par.1 të KPP, vlerësoj pretendimet në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë dhe gjeti se:

Kërkesa nuk është e bazuar.

Mbrojtësi pretendon se aktgjykimet e kundërshtuara janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, dhe atë duke u nisur nga çmuarja e provave dhe arsyetimi i tyre, ku dispozitat ligjore kanë përcaktuar në mënyrë eksplicite që gjykata ka detyrimin që të gjitha provat duke përfshirë ato fajësuese dhe shfajësuese t’i elaboroj dhe të nxjerrë përfundimet se pse ia falë besimin një prove të caktuar dhe përse nuk ja fal besimin një prove tjetër dhe të cilat fare nuk elaborohen nga gjykatat. Sipas kërkesës gjykatat kanë bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale për shkak të arsyetimit të mangët si dhe për shkak të shkeljes së ligjit penal për shkak që në rastin konkret në raport me kualifikimin e veprës penale nuk e ka marrë për bazë faktin se kjo vepër penale konsumohet ekskluzivisht me kalimin e vijës kufitare, kurse nga të gjitha provat është vërtetuar fakti se i dënuari Azem mallrat i ka pranuar në Republikën e Kosovës, përkatësisht në vendin e quajtur H. E., e që është fakt i pa kontestuar për shkak se i njëjti ka punuar si taksist dhe kryesisht në relacionin H.E. -K.-F..

Përveç kësaj nuk është marrë parasysh fakti se i dënuari duke punuar me profesion taksist ka bartur dy herë porosi nga H.E. në fshatin B. dhe për këtë është paguar nga 15€. Duke pasur parasysh këtë kemi situata të shpeshta që barten mallra të caktuara nga pikat kufitare deri në destinacionin e caktuar, ku në rastin konkret është e pamundur që të verifikohet nëse sendet nëpër pako kanë hyrë në mënyrë të rregullt dhe të ligjshme apo jo, dhe nuk është detyrë dhe obligim i taksistit që të verifikoj rregullsinë e hyrjes së mallit në pikat doganore, prandaj i dënuari nuk është përgjegjës për këtë çështje, sepse është përgjegjësi e zyrtareve doganorë dhe policisë kufitare. Me tej sipas mbrojtësit konfiskimit i automjetit është i pabazë, sepse, në njërin anë potencohet fakti se automjeti ka shërbyer si taksi, në anën tjetër konkludojnë se veprimtaria e T. ishte si mbulojë për kontrabandën e bërë me barna.

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate pretendimet e mbrojtësit në kërkesë nuk janë të bazuara. Në fakt mbrojtësi edhe pse i kundërshton aktgjykimet për shkelje esenciale nuk konkretizon se cila dispozitë është shkelur dhe në çka konsistojë këto shkelje, përveç që thekson se arsyetimi i aktgjykimeve është i mangët, kurse, kur bën fjalë për shkelje të ligjit penal i referohet gjendjes faktike (për të cilën bazë kërkesa nuk mund të paraqitet) ngase i kundërshton provat në bazë të të cilave gjykatat kanë nxjerrë përfundimin se i dënuari është përgjegjës për veprën penale për të cilën është shpall fajtor, me pretendim se këto prova nuk e argumentojnë faktin se në veprimet e të dënuarit përmbushen elementet e veprës penale për të cilën është shpall fajtor.

Megjithatë, kjo gjykatë vlerëson se aktgjykimet e kundërshtuara nuk përmbajnë shkelje esenciale të pretenduara në kërkesë, ngase dispozitivi i aktgjykimet të gjykatës së shkallës së parë është i qartë, në të janë përshkruar veprimet inkriminuese të të dënuarit, kurse, nga arsyetimi del qartë mënyra se si i dënuari ka vepruar si bashkekzekutor me të dënuarit tjerë të këtij rasti. Nga aktgjykimet e kundërshtuara dhe shkresat e lëndës del qartë se në rastin konkret të dënuarit si bashkekzekutor i kanë ndarë rolet e tyre, ashtu që i dënuari i parë i ka siguruar mallrat e kontrabanduara (barna) nga personat e panjohur nga Republika e Maqedonisë të cilat i kanë sjellë duke iu shmangur kontrollit doganor në vendkalimin kufitar -H.E., kurse i dënuari Azem Luta dhe i dënuari Ajet Lajçi, këto barna i kanë pranuar nga këta persona dhe nga kufiri i kanë sjellë tek shtëpia e të dënuarit Feriz Salihu, i cili pastaj i ka shpërndarë nëpër barnatore të ndryshme, e që kjo vërtetohet nga provat e administruara në veçanti masat e fshehta teknike të hetimit dhe vëzhgimit- bisedat telefonike në mes të dënuarve, kurse është jashtë logjike të pretendohet se i dënuari Azem kishte rolin e ... dhe nuk kishte njohuri se çka kishte në pako.

Në fakt pretendimet në kërkesë nuk e venë në dyshim saktësinë e fakteve vendimtare të vërtetuara me aktgjykimet kundër të cilave është paraqitë kërkesa, kurse, meqë gjykatat në këtë drejtim kanë dhënë arsye të qarta, kjo gjykatë nuk e sheh të nevojshme të bëjë edhe njëherë vlerësime në këtë drejtim, pra, kjo gjykatë e mbështet konkludimin e gjykatave se në veprimet e të dënuarit qëndrojnë elementet e veprës penale për të cilën është shpall fajtor dhe gjykuar.

Kjo, gjykatë edhe pretendimet sa i përket konfiskimit të automjetit i konsideron si të pabazuara. Duke pasur parasysh faktin se automjeti i dënuarit ka shërbyer si mjet për transportimin e mallrave, gjykata ka vepruar drejtë kur e ka konfiskuar atë konform dispozitës së nenit 311 par.7 të KPRK-së.

Për arsyet e lartcekura kërkesa u refuzua si e pabazuar, kurse konform dispozitës së nenit 437 të KPP vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Procesmbajtësi
Bujar Balaj

Kryetare e kolegjit,
Valdete Daka